

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 621 Prot.

Tiranë, më 10.05 2017

VENDIM Nr. 60, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Topografia Epidamne-Dyrrhachion, Durrës"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. As. Eduard Shehi dhe Prof. Dr. Catherine Abadie-Reynal, Universitë Lumière-Lyon, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Topografia Epidamne-Dyrrhachion, Durrës"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. As. Eduard Shehi dhe Prof. Dr. Catherine Abadie-Reynal, Universitë Lumière-Lyon, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Në Termat Publike.
 - Gërmimi në lulishten e Pallatit të Kulturës parashikon zgjerimin e gërmimit në funksion të zbulimit të strukturave të tjera të termave romake. Në këtë sipërfaqe nga ana e Bashkisë Durrës synohet të realizohet një projekt publik. Realizimi i gërmimeve nga projekti i IA mbështet punimet e Bashkisë e cila nuk do të shpenzojë për aspektin arkeologjik. Territori mendohet të lihet i hapur pas gërmimeve për t'u bërë i vizitueshëm dhe për t'u lidhur më vonë me hapsirat e tjera arkeologjike pranë.
 - Gërmimi në Bastionin Juglindor (përballë Portit të qytetit) parashikonte gërmimin e linjës fortifikuese të qytetit. Por duke qenë se ky gërmim është duke u realizuar tani, është spostuar realizimi i sondazhit ngjitur bastionit, në mes të kullave A (të ashtuquajtur torra veneciane) dhe kullës B. Qëllimi lidhet me identifikimin dhe datimin e qartë të ndërhyrjeve ndërtimore mesjetare në këto mure. Sondazhi do të mbyllet pas gërmimit dhe zona do të kthehet në gjendjen e mëparëshme.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë periudha kohore e nevojëshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2017.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO